

VENDIM
Nr. 172, datë 18.3.2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 36, DATË 20.1.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MBIKËQYRJES SË
TREGUT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 10480, datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, dhe të pikës 3, të nenit 16, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun III, “Organizimi dhe funksionimi i ISHMT-së”, të vendimit nr. 36, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 7 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Marrëdhëniet e punës së Kryeinspektorit dhe të punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.”.

b) Pas pikës 7 shtohen pikat 7/1, 7/2 dhe 7/3, me këtë përmbajtje:

“7/1. Kryeinspektori emërohet në detyrë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të ketë diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional”, të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit për arsimin e lartë për shkencat ekonomike/juridike;

ç) të ketë përvojë në profesion, të paktën 3 (tri) vite;

d) të shquhet për figurë të pastër etiko-morale;

dh) të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;

e) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

ë) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

f) të mos ketë konflikt interesi me detyrën në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.

7/2. Kryeinspektori lirohet nga detyra me urdhër të Kryeministrit kur:

a) plotëson moshën për pensionin e plotë të pleqërisë;

b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

c) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;

ç) jep dorëheqjen nga detyra;

d) konstatohet performancë e dobët;

dh) konstatohet në kushtet e ndalimit për kryerjen e funksioneve publike sipas legjislacionit për integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

7/3. Kryeinspektori shkarkohet nga detyra me urdhër të Kryeministrit:

a) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo të një kundërvajtjeje penale me dashje;

b) kur me veprimet e kryera gjendet në një situatë të konfliktit të interesit;

c) në rastet e mospërmbushjes së rëndë të detyrave;

ç) kur në mënyrë të përsëritur nuk respekton afatet e caktuara për përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja shumë të rënda;

d) në rastet e moszbatimit haptazi të dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale;

dh) kur braktis punën ose mungon në punë në mënyrë të pajustificuar dhe të vijueshme për 15 ditë pune e më shumë.”.

c) Nga fjalia hyrëse e pikës 8 hiqen fjalët “... është titullari i institucionit, i emëruar sipas përcaktimeve të legjislacionit për nëpunësin civil, dhe ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama